

## Misioni

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, është institucion akademik e konkurrues i orientuar në ofrimin e edukimit cilësor duke zhvilluar kërkime shkencore dhe duke kontribuar në inovacion, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe komunitetit ku vepron në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

## Vizioni

Universiteti ndërton vizionin duke u mbështetur në parimin e vlerave edukativo-kërkimore, përparësive krahasuese të diversitetit etnik, gjuhësor dhe kulturor, me qëllim të krijimit të një qendre të ekselencës akademike e cila do t'i shërbejë studentëve, hulumtuesve dhe shoqërisë në fushat e TI, agrobiznesit dhe mjedisit, menaxhmentit dhe administrimit të biznesit, drejtësisë, gjuhësisë dhe edukimit.

Adresa:

Rruga e Shkronjave 1, 20000 Prizren, Kosovë

[www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

[rektorati@uni-prizren.com](mailto:rektorati@uni-prizren.com)

Tel +383 29 232 140

# Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”

Universiteti më diversiv në  
Republikën e Kosovës



[www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)



## Vështrim i shkurtër i Universitetit të Prizrenit

Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” është themeluar më 09.10.2009 me vendimin numër 01/87 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe pas një pune përgatitore intensive me konsulentë ndërkombëtarë filloi të funksionojë zyrtarisht në vitin 2010. Tradita e arsimit të lartë në Prizren ka zanafillën më herët me Shkollën e Lartë Pedagogjike të saj në vitin 1962 të cilën e trashëgoi Universiteti i Prizrenit. ShLP-ja u pavarësua nga Universiteti i Prishtinës i cili është institucioni më i vjetër i EL. ShLP-ja në Prizren është shndërruar në Fakultetin e Edukimit në Prizren nën ombrellën e Universitetit të Prishtinës. Që nga viti 2010/2011, Fakulteti i Edukimit, i cili deri në atë kohë funksiononte në kuadër të UP-së, u transferua në UPZ. E veçanta e Fakultetit është se studimet ofrohen edhe në gjuhët e komunitetit (në gjuhën boshnjake dhe në atë turke)

Ne ofrojmë studime në të gjitha gjuhët e folura në Kosovë.

## Programet e Studimit

### Fakulteti Ekonomik

1. Administrim Biznesi
2. Menaxhim Ndërkombëtar
3. Kontabilitet dhe Auditim(Master)
4. Administrimbiznesi(Master)

### Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

5. Agrobiznes
6. Shkencat e pyjeve dhe mjedisit

### Fakulteti i Edukimit

7. Edukim fillor
8. Edukim parashkollor
9. Edukim parashkollor (në gjuhën turke)
10. Eudkim fillor (në gjuhën turke)
11. Edukim parashkollor (në gjuhën boshnjake)
12. Edukim fillor (në gjuhën boshnjake)

### Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

13. Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikimi
14. Dizajnim i softuerit
15. Shkenca kompjuterike dhe teknologji (Master)
16. TIT në gjuhën turke
17. TIT në gjuhën boshnjake

### Fakulteti Juridik

18. Juridik

### Fakulteti i Filologjisë

19. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
20. Gjuhë dhe Letërsi Angleze
21. Gjuhë dhe Letërsi gjermane

## Qyteti i Prizrenit

Prizreni shtrihet në fund të Maleve të Sharrit dhe afër Rahovecit, rajonit të verës. Është qyteti i dytë kosovar përplot histori, dyqane tradicionale të artizanaleve dhe ushqim të shijshëm. Po ta gërshetoni këtë me natyrën e mrekullueshme dhe festivalin e njohur veror të filmit mund të themi që Prizreni është një destinacion që “duhet futur patjetër” në itinerarin tënd të udhëtimit në Ballkan.

